



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë **19.06.2024 Nr. Akti 63**, ka paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen për shqyrtim të veprës penale ndaj të pandehurit **Fatmir Ejupi** me objekt: Marrje në pyetje dhe verifikimin e kushteve për zbatimin e masës së sigurimit në lidhje me të pandehurin **Fatmir Ejupi**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Falsifikimit të vulave, stampave dhe formularëve*” e kryer në formën e falsifikimit të formularëve të miratuar nga personi që ka për detyrë hartimin e tyre dhe në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 190/3 dhe 25 të Kodit Penal.
2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata bazuar nenin 248 K.Pr.Penale me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Elsa Ulliri, me vendimin Nr. **63**, datë 20.06.2024, vendosi:
 1. Pranimin e kërkesës.
 2. Verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*Arresti në burg*” të caktuar ndaj të pandehurit **Fatmir Ejupi** me vendimin Nr.Akti 57, datë 06.06.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe zëvendësimin me masën e sigurimit personal “*Garanci pasurore*”, e parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale, në shumën prej 700,000 lekë, për të siguruar moslargimin e shtetasit **Fatmir Ejupi** deri në përfundimin e gjykimit.
 3. Garancia pasurore duhet të depozitohet brenda afatit 2 ditor, duke filluar ky afat nga shpallja e këtij vendimi. I pandehuri **Fatmir Ejupi** do të qëndrojë me masën e sigurimit “*Arresti në burg*” deri në depozitimin e garancisë pasurore. Pas depozitimit të shumës përkatëse duhet të njoftohet menjëherë prokurori, i cili në çdo rast jo më vonë se 24 orë nga njoftimi për depozitimin e shumës së

garancisë pasurore, duhet të verifikojë dokumentacionin përkatës dhe sipas rastit të urdhërojë lirim të menjëhershëm të të pandehurit ose konfirmimin e masës së sigurimit “*Arresti në burg*”.

4. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.

Tiranë, me datë 20.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar